



Pranimar / Dorëzuar Puniljena / Prudato Received / Delivered	23-06-2023	3	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org. Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKRMSTHEK	4899/2023		1/4



Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.687/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Malsore Gashi-Bajraktar-Kryetare, Arben Mehmeti, Ardita Haxhnikaj-Demi-Anëtarë dhe Kaltrina Avdullahi Prenaj-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.687/2023 të datës 28.04.2023 të parashtruar nga ankuesi

Rr. _____ kundër Vendimit me numër 01-Nr.016-22321 të datës 04.04.2023 i Komisionit Disiplinor në Komunën e Suharekës, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datën 23.06.2023 mori këtë:

V E N D I M

I. SHFUQIZOHET Vendimi me numër 01-Nr.016-22321 i datës 04.04.2023 i Komisionit Disiplinor në Komunën e Suharekës dhe *çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje tek organi i njëjtë.*

II. OBLIGOHET Komisioni Disiplinor në Komunën e Suharekës, që brenda afatit prej 15 ditësh nga dita e pranimin të bëjë zbatimin e këtij vendimit, të bëjë rishqyrtimin e këtij rasti si në pikën I të dispozitivit.

III. OBLIGOHET Kryetari i Komunës së Suharekës që të kujdeset për zbatimin e këtij vendimi si në pikën III.

IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

Ndaj _____ i punësuar sipas Akt Emërimit me numër 01-Nr-21 të datës 28.12.2011 në pozitën e punës "Ofiqarë" në Drejtorin e Administratës dhe Inspektionit në Komunën e Suharekës, më datë 06.03.2023 Shefi i Gjendjes Civile në Komunën e Suharekës ka parashtruar kërkesës me numër të protokollit Nr.02-104-15794 për iniciimin e procedurës disiplinore.

Komisioni Disiplinor më datë 04.04.2023 ka nxjerr Vendim me numër 01-Nr.016-22321, me të cilin ankuesit i shqiptohet masa disiplinore, *ndalim i pagës në masën 30% për periudhën prej 3 muaj*.

Ankuesi i pakënaqur me Vendimin me numër 01-Nr.016-22321 të datës 04.04.2023, brenda afatit ligjor komfor nenit 12 të Ligjit Nr. 03/L-192 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, me datën 28.04.2023, ka parashtruar ankesë me numër protokolli 3910/2023 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendorsjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 12.05.2023 ka dërguar kërkesë për përgjigje në ankesë te Komuna e Suharekës. Ndërsa Këshilli më datë 15.05.2023, ka pranuar përgjigje në ankesë.

Me Vendimin me numër protokolli 4643/2023 të datës 09.06.2023, Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka vazhduar afatin për vendosje të ankesës me numër A.nr.687/2023 të datës 28.04.2023 edhe dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave ka Administruar këto Prova: Ankesë me numër të protokollit 3910/2023 e datës 28.04.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Vendim me numër të protokollit 01-Nr.016-2231 i datës 04.04.2023; Ftesë e datës 21.03.2023; Deklaratë e datës 06.03.2023; Kërkesë për tërheqje nga lënda me numër 02/181 e datës 09.03.2023; Kopje e letërnjoftimit; Shkresë e datës 22.03.2023; Raport mjekësor i datës 20.03.2023; Raport mjekësor i datës 07.03.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë e datës 12.04.2023; Përgjigje në ankesë e datës 15.05.2023; Akt Emërim me numër 01-Nr-21 i datës 28.12.2023; Përshtkrimi i detyrave të punës i datës 12.12.2023; Vendim me numër 01-Nr-410-16431; Vendim me numër 01-Nr.016-22321 i datës 04.04.2023; Procesverbal i datës 22.03.2023; Procesverbal i datës 27.03.2023; Njoftim me numër 02-181-15512 i datës 06.03.2023; Njoftim me numër 02-181-16229 i datës 08.03.2023; Kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj zyrtarit të Gjendjes Civile me numër 02-104-15794 e datës 06.03.2023; Akt përcjellës 01-016-16489 i datës 09.03.2023; Ankesë 02-070-50181 e datës 29.07.2019; Përgjigje në shkresë me numër NR.02/16-51143 e datës 31.07.2019; Formulari për vlerësimin e rezultateve në punë i datës 01 Janar 2021-31 Dhjetor 2021; Formulari për vlerësimin e rezultateve 10.01.2023.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës ka konstatuar që janë përmbushur kushtet ligjore që lënda të kthehet në *rishqyrtim dhe rivendosje* të organi i njëjtë, *sepse*:

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendorsjen e Ankesave ka konstatuar se Komisioni Disiplinor në Komunën e Suharekës ka nxjerrë Vendim me numër të protokollit 01-Nr.016-22321 më datë 04.04.2023, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masë disiplinore *“Ndalim i pagës në masë 30% për periudhën prej 3 muaj”*.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër të protokollit 01-Nr.016-22321 të datës 04.04.2023 të

Komisionit Disiplinor në Komunën e Suharekës, pretendon se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore ndaj tij ka bërë, vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, shkelje të dispozitave të Ligjit nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik dhe Rregullores me numër Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik si dhe aplikim të gabuar të së drejtës materiale.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik referuar procedurave disiplinore, përkatësisht: Neni 46 me të cilin përcaktohet se: "1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 2.2. shkelje të lehta." 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda; 3.3. moszbatimi i dispozitave ligjore për përmbushjen e detyrave funksionale; 3.4. përfitimi në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë të dhuratave, favoreve, premtimeve ose trajtimeve preferenciale, të cilat jepen për shkak të detyrës; 3.5. braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë; 3.6. shkelje e përsëritur e rregullave të kodit të etikës në Shërbimin Civil; 3.7. dëmtimi i pasurisë shtetërore, përdorimi i saj jashtë përcaktimit zyrtar apo keqpërdorimi i pasurisë shtetërore; 3.8. kryerja e përsëritur, brenda ose jashtë orarit zyrtar, të veprimeve që cenojnë nëpunësit civilë, institucionin apo Shërbimin Civil në tërësi; 3.9. shkelja e rregullave për ruajtjen e informacionit të klasifikuar apo të mirëbesimit për të dhënat e klasifikuara si të tilla; 3.10. shkelja e detyrimeve të përcaktuara në këtë ligj dhe në legjislacionin në fuqi; 3.11. përdorimi i narkotikëve dhe substancave të tjera psikotrope të ndaluara ose të alkoolit në vend të punës dhe ardhja i dehur në punë. Rrjedhimisht në kuptim të dispozitave të lartëcekura si dhe duke u bazuar në provat e bashkangjitura në shkresat e lëndës Kolegji i Këshillit ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankuesit janë të bazuara sepse Komisioni Disiplinor në Komunën e Suharekës me Vendimin me numër të protokollit 01-Nr.016-22321 të datës 04.04.2023, me të cilin ankuesit i ka shqiptuar masë disiplinore "Ndalim i pagës në masë 30% për periudhën prej 3 muaj" nuk ka arritur të vërtetoj drejtë gjendjen faktike dhe juridike duke mos i konstatuar drejt elementet e përgjegjësisë disiplinore, rrjedhimisht nuk ka konstatuar saktë përgjegjësin disiplinore të përcaktuar me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 Për Zyrtarët Publikë, ku theksohet se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore ndërmjet veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", e që në rastin konkret Komisioni Disiplinor nuk i është referuar asnjë dispozite të Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë dhe Rregullores (QRK) Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publik, respektivisht nuk ka konstatuar shkeljet e kryera nga ankuesi, gjegjësisht nuk ka konstatuar që ankuesi me veprimet apo mos veprimet e tij gjatë kryerjes së detyrës zyrtare ka bërë shkelje të lehta apo të rënda-serioze të detyrave të punës të përcaktuara me nenin 46 të Ligjit Nr. 06/L - 114 Për Zyrtarët Publikë.

Po ashtu Komisioni disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 01-Nr.016-22321 të datës 04.04.2023, nuk ka arritur të shqyrtoj në mënyrë të drejtë provat materiale të lëndës dhe nuk ka arritur të konstatoj nëse janë plotësuar kushtet ligjore apo elementet e përgjegjësisë disiplinore të përcaktuar me nenin 45 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë, respektivisht nuk është konstatuar në mënyrë të drejtë përgjegjësia e ankuesit në këtë çështje juridike, si rrjedhojë nuk janë shqyrtuar elementet e nenit 50 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët

Publikë, mbi këtë bazë sipas Kolegjit të Këshillit, Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër 01-Nr.016-22321 të datës 04.04.2023 ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 11 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 12 paragrafi 3 të Rregullores Nr.11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë , si dhe në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, pasi që arsyetimi i vendimit është kundërthënës me vetveten, dhe si rrjedhojë i njëjti vendim është i paligjshëm në kuptim të nenit 52 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3, 1.5 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative ku përcaktohet se: "1. Një akt administrativ është i paligjshëm nëse: 1.3. është rezultat i shkeljes të dispozitave lidhur me procedurën administrative; 1.5. është në kundërshtim me ligjin material; 1.6. është rezultat i diskrecionit që është ushtruar në mënyrë jo të ligjshme", prandaj i njëjti është shfuqizuar sikurse në dispozitiv të këtij vendimi, ndërsa lënda e ankuesit ndërlidhur me procedurën e iniciuar disiplinore është kthyer në rishqyrtim dhe rivendosje tek Komisioni Disiplinor, pasi që Kolegji i Këshillit për shkak të lëshimeve procedurale nga Komisioni Disiplinor të përcaktuara si më lartë, nuk ka mundur të konstatoje saktë gjendjen faktike nëse ankuesi ka bërë shkelje të dispozitave të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë .

Nga të lartcekurat, Kolegji i Këshillit, meqenëse konstatoj se Vendimi me numër 01-Nr.016-22321 i datës 04.04.2023 i Komisionit Disiplinor në Komunën e Suharekës, është nxjerr si rezultat i shkeljeve procedurale, dhe meqë u konstatua se i njëjti është i paligjshëm, atëherë Kolegji i Këshillit obligon Komisioni Disiplinor në Komunën e Suharekës që në riprocedurë të rishqyrtoj rastin e ankuesit dhe të mënjanojë shkeljet procedurale dhe materiale, si dhe të merr parasysh konstatimet si në këtë vendim duke i eliminuar të gjitha këto shkelje, të nxjerr vendim në pajtim me legjislacionin përkatës.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.687/2023

Kaltrina Avdullahi Prenaj

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Malsore GASHI-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunës së Suharekës;
- Komisionit Disiplinor të Komunës së Suharekës;
- Njesisë së Burimeve Njerëzore në Komunën e Suharekës; dhe
- Arkivit të KPMShCK- së.